



02/Nr. 1716 /2018
Data: 28.02. 2018

PROCESVERBAL I KKSB-së

Nga mbledhja e dytë - II- për vitin 2017 mbajtur me datë: 23.02.2018 me fillim pune në ora 14:00, prezent ishin: **Nuhi Dema** (përfaqësues i stacionit policor), **Vahid Hyseni** (përfaqësues i policisë kufitare –vija e gjelbërt), **Isni Bushi** (përfaqësues i këshillit të prindërve), **Ali Vishi** (përfaqësues i FSK-së), **Menduh Vlashi** (përfaqësues i drejtorisë për arsim, kulturë, rini dhe sport), **Refet Kalisi** (përfaqësues i drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë), **Amir Bushi** (përfaqësues nga zyra për barazi gjinore), **Isa Shkreta** (përfaqësues i E.V.S.B), **Qamil Kalisi** (përfaqësues i Hendikosit).

Takimin e kryesoj kryetari i komunës z. **Rufki Suma**.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.
3. Shqyrtimi i njoftim për aktivitetet e këshilli komunal për siguri në bashkësi për vitin 2017.
4. Të ndryshme.

Rufki Suma pasi përshëndeti të pranishmit lexoi rendin e punës dhe pasi që nga të pranishmit nuk pati vërejtje në rendin e punës, njëzëri u miratua rendi i punës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rufki Suma a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.

Rufki Suma lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nuhi Dema gjatë këtij muaji kemi pas 5 (pesë) raste të ndryshme. Probleme kemi me kompaninë “Bektelenka” gjatë kryerjes së punimeve të autostradës për shkak të ndotjes së rrugës. Kemi shqiptuar dënime për disa kamion të kompanisë “Bektellenka” të cilët ishin të pa regjistruar. Situata e sigurisë ishte e qetë gjatë këtij muaji.

Vahid Hyseni gjatë këtij muaji kemi pas vetëm një rast të kalimit ilegal. Situata e sigurisë ishte e qetë gjatë këtij muaji.

Isni Bushi si këshill i prindërve kemi bërë një kontroll në shkollën e mesme “Dardania” për shkak se po flitet se ka përdorime të substancave të ndryshme, mirëpo gjatë kontrollës nuk kemi gjet diçka që është shqetësuese përveç se kemi gjet cigare dhe ndonjë shkrebz. Drejtori i shkollës fillore “Kështjella e Diturisë“ në fshatin Paldenicë ka paraqitur një shqetësim për qenët shtëpiak sepse nxënësit i janë shqetësuar.

Menduh Vlashi është një dukuri kohët e fundit por është faza faza dhe nga një herë përleshën në mes vete nxënësit dhe kohët e fundit ka probleme.

Nuhi Dema për rastin e qenve shtëpiak në fshatin Paldenicë jemi marr vesh me pronarin dhe e ka larguar nga shtëpia qenin të cilin e ka pas. Çështja e nxënësve që u përmendë kemi hap rast dhe rastin është proceduar në organet përkatëse.

Rufki Suma a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka si vlerësim i përgjithshëm është se gjendja e sigurisë në komunën e Hanit të Elezit është e mirë.

3. Shqyrtimi i njoftim për aktivitetet e këshilli komunal për siguri në bashkësi për vitin 2017.

Rufki Suma në këtë takim shqyrtohen aktivitetet e KKSB-së për vitin 2017 dhe pastaj përcillen për në komitet për politik e financa dhe në kuvendin e komunës sepse udhëzimi administrativ e parasheh. Materialet i keni pranuar me kohë dhe nëse keni edhe ndonjë aktivitet që nuk është përfshirë mund ta propozoni. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4. Të ndryshme.

Rufki Suma sot kam pranuar një informatë nga banorët e fshatit Paldenicë të cilët do të protestojnë për shkak se kanë informacione se do të mbyllet rruga te vendi i quajtur dheu i bardhë që shkon në drejtim të fshatit Paldenicë. Si komunë të gjitha vërejtjet të cilët i kanë parashtruar banorët e Hanit të Elezit ua kemi përcjellë Qeverisë dhe përfaqësuesve të kompanisë “Bektelenka”. Me datë 26.02.2016 është dita e krismës së pushkës së parë në Puset e Nikës. Në ora 15:00 do të jetë vizitë te varrezat e Dëshmorëve. Në ora 16:00 në shtëpi të kulturës do të shfaqet dokumentari për Jahush Shkretën.

Isni Bushi në vendin quajtur Uji i Thartë kompania “Bektelenka” e ka grumbulluar dheun dhe e ka ndërruar trasenë e rrugës. Nëse rritet niveli i lumit Lepenc ekziston mundësia e shembjes së Kodrës.

Rufki Suma kemi biseduar për këtë çështje dhe kemi kërkuar që me trajtuar atë pjesë.

Mbledhja përfundoi në ora 14: 45 ju faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

